



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 7, datë 14.01.2021

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi i gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



EKSTRAKT

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME
QËLLIM PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË
VLERËSIMIT (GRADIMIN) E {...}



ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short)

Në Raportin e K.L.GJ.-së, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “... Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi të mira, në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se në përgjithësi ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret....Nga 3 vendimet e përzgjedhura nga vetë subjekti dhe 5 dosjet e përzgjedhura me short del se subjekti përgjithësisht i njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i zbaton ato në praktikë dhe i bën pjesë të vendimeve gjyqësore shprehimisht. Në çështjet e trajtuara ka të dhëna për njohjen dhe zbatimin e të drejtës ndërkombëtare, Konventën e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (shih dokumenti 1)...”.

Nga analiza e 11 dosjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga ana e gjyqtares për vlerësim, rezultojnë se:

POLI I DREJTËSISË

RRUGA “ANA KOMNENA”

TIRANË

⋮

Konkretisht, faktet e çështjes përcaktohen nëpërmjet përshkrimit në nënndarjen e titulluar “Fakti penal”, në të cilën përshkruhet fakti penal objekt akuze, siç ka rezultuar i provuar gjatë gjyqimit. Pas parashtrimit të faktit, arsyetimi i vendimit vijon me parashtrimin e provave mbi të cilat mbështetet fakti penal i provuar gjatë gjyqimit. Provat, në varësi të procedurës së gjyqimit të ndjekur (gjykim i zakonshëm ose gjykim i shkurtuar) parashtrihen dhe/ose citohen (*në rastin e dëshmimeve, bisedave telefonike të transkriptuara etj*), të shoqëruara me evidentim të fakteve konkrete, të cilat provohen nëpërmjet secilës provë, ose disa provave të analizuara së bashku. Paraqitja dhe analiza e provave dhe fakteve që rezultojnë prej tyre zë një pjesë të konsiderueshme të pjesës arsyetuese të vendimeve gjyqësore të vëzhguara, në shërbim të provueshmërisë së elementëve të figurës së veprës penale dhe lidhjen e autorit apo autorëve, sipas rastit, me kryerjen e veprës. Gjithashtu, në disa prej vendimeve, duke iu referuar natyrës së çështjes, evidentohen dhe analizohen faktet që kanë të bëjnë me mbetjen e veprës penale në fazën e tentativës (dosja 1, dosja 6, dosja 7, vendimi 2, vendimi 3), elementët e bashkëpunimit (dosja 3, dosja 6, dosja 8, dosja 9, vendimi 3), cilësinë dhe rolin e secilit të pandehur në faktin penal të provuar, etj.

Pas parashtrimit dhe analizës së provave mbi të cilat mbështetet fakti penal i evidentuar në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të çdo vendimi, në nënndarjen e titulluar “Vlerësimi i gjykatës”, përsëri i kushtohet rëndësi faktit penal nëpërmjet analizës së integruar të provave të marra gjatë gjyqimit, në shërbim të konkluzioneve që gjykata ka arritur lidhur me kualifikimin ligjor të faktit dhe rolin e secilit të pandehur, duke bërë një analizë të mirëfilltë të provave në këtë pjesë të vendimeve të vëzhguara. Në 14 vendimet e shqyrtuar evidentohet aftësi shumë e mirë e gjyqtarës për të identifikuar natyrën e faktit penal objekt gjykimi, në raport me rrethanat e provuara në gjykim. Gjyqtarja në evidentimin e faktit penal, i kushton rëndësi analizës së elementeve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale, analizës së elementëve cilësues të veprave penale për të cilat procedohet, si dhe ka proceduar me ndryshimin e kualifikimit ligjor (vendimi 2) të faktit në rastet kur është vlerësuar se fakti penal nuk është kualifikuar në mënyrë korrekte, sipas vlerësimit të saj.

Në çështjet me karakter të posaçëm për konfiskimin e pasurisë, faktet evidentohen dhe analizohen në mënyrë të hollësishme, si dhe i kushtohet rëndësi qartësimi të natyrës së çështjes, pavarësisë së faktit objekt hetimi pasuror nga fakti penal për të cilën procedohen personat e dyshuar në një procedim, të pavarura nga procedimi në hetimin pasuror (dosja 4), si dhe i kushtohet rëndësi paraqitjes dhe analizës së provave të paraqitura nga palët, në raport me kushtet ligjore për aplikimin e konfiskimit të pasurisë, sipas parashikimeve të ligjit të posaçëm (neni 24 të ligjit nr.10192/2009).

Lidhur me identifikimin e ligjit të zbatueshëm, në vendimet e vëzhguara rezulton referimi në dispozitat e ligjit procedural, në rastet e shqyrtimit të kërkesave paraprake të palëve, si dhe përcaktimi i bazës ligjore procedurale në lidhje me vendimmarrjen e gjykatës për fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, disponimin për provat materiale etj. Ndërkohë, evidentohet referimi i ligjit penal material në lidhje me kualifikimin ligjor të faktit penal objekt akuze, në lidhje me llojin dhe masën e dënimit, kriteret ligjore për individualizimin e dënimit etj. Në vendimet me karakter të posaçëm (dosja 4) përcaktohet ligji i zbatueshëm dhe referimi i drejtpërdrejtë në dispozitat e tij, lidhur me afatin e shqyrtimit të kërkesës për konfiskim, kriteret ligjore që duhet të ekzistojnë për konfiskimin e pasurisë, fusha e zbatimit të ligjit me karakter parandalues, etj.

...

Në lidhje me konfliktin e normave, në vendimet e vëzhguara nuk rezultojnë të jetë evidentuar konflikt i normave procedurale ose materiale, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Në tërësi, në 11 vendimet e vëzhguara rezultojnë aftësi shumë të mira të gjyqtarëve për të përcaktuar faktet e çështjes, shoqëruar me paraqitjen dhe analizën e provave mbi të cilat mbështeten faktet për të cilat gjykata konkluduar se rezultojnë të provuara. Po kështu, gjyqtarja në pjesën e analizës, rimerr në analizë faktin penal të provuar, lidhur me kualifikimin ligjor, elementët e veprës penale dhe rolin e secilit të pandehur. Gjithashtu, evidentohet përcaktim dhe referim i drejtpërdrejtë i dispozitave të ligjit procedural dhe ligjit material, në lidhje me rrethanat objekt gjykimi. Përveç dispozitave të ligjit procedural dhe material penal, gjyqtarja në caktimin e llojit të institucionit të vuajtjes së dënimit, identifikon dhe referon në parashikimet e Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta për identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në treguesin e “aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Nga 3 vendimet e përzgjedhura nga vetë subjekti dhe 5 dosjet e përzgjedhura me short del se subjekti përgjithësisht i njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i zbaton ato në praktikë dhe i bën pjesë të vendimeve gjyqësore shprehimisht. Në çështjet e trajtuara ka të dhëna për njohjen dhe zbatimin e të drejtës ndërkombëtare, Konventën e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (shih dokumenti 1). Gjyqtarë {...} në përgjithësi bën lidhjen e pjesës së përgjithshme me atë të posaçme të Kodit Penal, duke identifikuar rastin kur vepra penale është kryer në bashkëpunim (shih dokumenti 3 dhe dosja 3), kur vepra penale nuk është përfunduar dhe ka mbetur në tentativë (shih dokumenti

2, 3 dhe dosja 7), si dhe njeh kriteret e individualizimit të masave të dënimit (shih dokumenti 3 dhe dosja 3)...”;

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, përshkruar më sipër në akt, rezulton se:

Në vendimet përfundimtare të gjyqtarës identifikohet, dhe në disa raste citohet dhe analizohet norma ligjore konkrete në shërbim të analizës së fakteve dhe konkluzioneve të arritura lidhur me zbatimin e normës. Normat ligjore të ligjit penal procedural dhe material, citohen dhe merren në shqyrtimin në pjesën në të cilën pasqyrohet vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesat paraprake të palëve (dosja 3, dosja 9, dosja 10 dhe vendimi 3), ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal (vendimi 1) dhe me tej në pjesën e “vlerësimit të gjykatës”, duke u shoqëruar, në disa raste, me interpretimin e tyre dhe analizën në lidhje me aplikimin mbi faktet e çështjes. Në pjesën e vlerësimit të gjykatës, analiza ligjore është konkrete dhe e integruar bashkë me analizën e faktit penal të provuar në gjykim.

Në tërësinë e vendimeve, kuptimi i ligjit procedural është dhënë duke e integruar me rrethanën procedurale me të cilën ai gjen zbatim, si në rastet e aplikimit të gjykimit të shkurtuar (dosja 3, dosja 9, dosja 10 dhe vendimi 3), vlerën provuese të deklarimeve të të pandehurve gjatë hetimit (dosja 8), rastin e ndarjes së çështjes dhe deklaramit të moskompetencës (dosja 9), etj.

Në lidhje me dispozitat e ligjit penal material, në vendimet e vëzhguara rezulton referim dhe zbatim i drejtpërdrejtë i tyre, duke integruar analizën e ligjit bashkë me rrethanat e faktit konkret mbi të cilin ajo gjen zbatim, pa bërë një analizë specifike të dispozitave të ligjit material. Kryesisht gjykata ndalet në dhënien e kuptimit të tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktin konkret, ose elementin e veprës penale në lidhje me të cilin ato referohen, siç është rasti i përcaktimit të formës së kryerjes së veprës penale, bashkëpunimin si element cilësues i veprës penale (dosja 9), kriterëve ligjore për vendosjen e masës së konfiskimit të pasurisë (dosja 4), kuptimin e tentativës (dosja 1, dosja 7, vendimi 3), kriteret e caktimit të llojit dhe masës së dënimit me qëllim individualizimin e tij, caktimin e dënimit për disa vepra penale (dosja 9, vendimi 1), etj. Nuk evidentohet një analizë e veçantë e normave të ligjit, përveç disa rasteve në të cilat janë analizuar elementët e anës objektive dhe subjektive të veprës penale, të tilla si forma e kryerjes së veprës, roli i të pandehurit në raport me faktin, etj. (vendimi 102 datë 30.09.2015 në të cilin analizohet kuptimi i nenit 283 dhe 278 i Kodit Penal në drejtim të elementëve të anës objektive të veprave penale).

Në vendimet përfundimtare evidentohet përcaktimi i saktë, i qartë dhe i kuptueshëm i fakteve të çështjes, identifikimi i normës/normave ligjore konkrete në lidhje me çdo çështje, referimi dhe aplikimi i drejtpërdrejtë i tyre mbi rrethanat e faktit dhe vetëm në disa raste gjyqtarja ka marrë në analizë të posaçme dhe ka interpretuar kuptimin e dispozitave, në shërbim të arsytimit për çdo fakt që lidhet me provueshmërinë elementëve të veprave penale për të cilat procedohet, kryesisht në rastet në të cilat ka proceduar me ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal. Në vendimet e administruara evidentohet aftësia e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, në lidhje me arsyet e aplikimit të procedimit me gjykim të shkurtuar (vendimi 2, dosja 7) dhe në një rast, në lidhje me format e kryerjes së veprës penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”(dosja 9).

Gjithashtu, në një rast identifikohet dhe zbatohet parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit në raport me pretendimin e prokurorisë për cilësimin e të pandehurit si përsëritës, për efekt të përcaktimit të llojit dhe masës së dënimit, kërkim ky që është parashtruar në diskutimin përfundimtar të një procesi të zhvilluar me gjykim të shkurtuar. Në raport me aplikimin e këtij

parimi, gjykatat referon edhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr.4/2012, në shërbim të konkluzionit të saj për mosmarrjen parasysh të këtij kërkimi. (dosja 9)

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të zgjidhjes së çështjes të nivelit “mbi mesatar”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...Subjekti i rivlerësimit {...} i harton vendimet përgjithësisht me strukturë të standardizuar. Vendimet përfundimtare të tij respektojnë kërkesat e ligjit procedural penal. Përmbajtja e vendimit përgjithësisht është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në përgjithësi në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja dhe përgjithësisht analiza ligjore është e thelluar, duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe duke dhënë arsyet pse ajo zbatohet në rastin konkret. Në analizën ligjore mungojnë sipas rastit, referenca në normat ndërkombëtare, KEDNJ, por edhe referenca në Jurisprudencën e GJEDNJ. Në një rast ka referencë në Konventën e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (shih dokumenti 1). Në përgjithësi ka referencë në Jurisprudencën e Gjykatës së Lartë (vendimet unifikuese), kryesisht për gjykimin e shkurtuar... Dispozitivi hartohet me tekst të qartë dhe të plotë, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin e fajësisë, vendin e vuajtjes së dënimit, disponimi për provat materiale e gjer tek e drejta e ankimit...”.

Referuar akteve të 11 dosjeve që përbejnë burim vlerësimi dhe 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga ana e gjyqtares rezulton se :

Vendimet përfundimtare të gjyqtares janë në çdo rast të organizuara sipas një strukture të qartë dhe të standardizuar. Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të

gjkimit, të dhëna të plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë, nenet përkatëse të Kodit Penal, si dhe kërkimet e palëve në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është sipas një strukture të standardizuar, të organizuar me nënndarje, të cilat shoqërohen me tituj identifikues dhe të renditura sipas një rrjedhe logjike me njëra tjetrën.

Dispozitivi i vendimeve është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbledhur në mënyrë të plotë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurve, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin e masën e dënimit, bashkimin e dënimeve, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar kur është aplikuar, kohën e fillimit të llogaritjes së dënimit, institucionin e vuajtjes së tij, disponimi për provat materiale, shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore, si dhe disponimin për të drejtën e ankimit.

Në veprimet për drejtimin e seancave gjyqësore dhe vendimet përfundimtare përdoret gjuhë e thjeshtë, e qartë, e kuptueshme dhe e drejtpërdrejtë. Evidentohet në të gjitha aktet e analizuara respektimi i rregullave gramatikore dhe të sintaksës, por mungon përdorimi i të gjitha shkronjave të gjuhës shqipe (*nuk përdoren shkronjat ë dhe ç*). Fjalitë janë me gjatësi mesatare, të thjeshta, të kuptueshme dhe të organizuara qartë. Në një rast, gjykata i ka kushtuar rëndësi terminologjisë së ligjit dhe kuptimit të saj, duke referuar edhe në kuptimin e tyre sipas fjalorit të gjuhës shqipe, në lidhje me fjalët “mbajtje” dhe “banesë”, për të dhënë kuptimin e termit “mbajtje në banesë”, si formë e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal dhe element cilësues i veprës penale në rastin konkret (dosja 9).

Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi mbi mesataren të arsyetimit ligjor në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

...

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “...Subjekti i rivlerësimit {...} i harton vendimet përgjithësisht me strukturë të standardizuar. Vendimet përfundimtare të tij respektojnë kërkesat e ligjit procedural penal. Përmbajtja e vendimit përgjithësisht është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në përgjithësi në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja dhe përgjithësisht analiza ligjore është e thelluar, duke paraqitur normën penale të zbatueshme dhe duke dhënë arsyet pse ajo zbatohet në rastin konkret...”.

Referuar akteve të 11 dosjeve që përbejnë burim vlerësimi dhe 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja rezulton se :

Vendimet përfundimtare, në aspektin strukturor kryesisht janë ndërtuar sipas një modeli të mirë përcaktuar duke evidentuar qartë tri pjesët përbërëse të vendimit (pjesa hyrëse, arsyetimi, pjesa urdhëruese).

Pjesa përshkruese-arsyetuese e vendimit gjithashtu ndjek një strukturë të mirë përcaktuar, të organizuar me nëndarje kryesore, shqyrtimi i kërkesave paraprake (dosja 3, dosja 9, dosja 10 dhe vendimi 3), fakti penal ose rrethanat e faktit të provuara gjatë gjykimit, pasqyrimi dhe analiza e provave, vlerësimi i gjykatës, si dhe individualizimi i dënimit.

Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, konçize, e plotë, e thjeshtë dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës, duke treguar sipas rastit të gjitha disponimet që shoqërojnë vendimin e fajësisë, vendin e vuajtjes së dënimit, provat materiale, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore, si dhe të drejtën e ankimit.

Në rastin e disponimit për kërkesën e prokurorisë për konfiskimin e pasurisë, si një lloj i veçantë procedimi dhe vendimmarrjeje, vendimi është sërish i organizuar sipas një strukture të qartë dhe të kuptueshme, të organizuar në paragrafë të cilët qëndrojnë të ndarë dhe titulluar sipas përmbajtjes, por lidhen me njëri tjetrin në mënyre logjike. Për shkak të natyrës së veçantë të procedimit dhe vendimit, i kushtohet rëndësi renditjes së arsyeve të vendimmarrjes së gjykatës, të cilat përmbajnë analizën e faktit, në raport me kriteret ligjore që duhet të përmbushen për të vendosur konfiskimin e pasurisë, vlerësimin për pretendimet e palëve, etj. Në këtë rast, dispozitivi i vendimit përmban disponimet e plota, sipas përcaktimeve të ligjit të posaçëm nr. 10192/2009, posaçërisht neneve 26 dhe 27 të tij, që përcaktojnë elementët e vendimit të gjykatës për konfiskimin e pasurisë, në rastin e rrëzimit të kërkesës, duke disponuar edhe për masën paraprake të sekuestrimit dhe mënyrën e ekzekutimit të vendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“...Niveli i arsytimit të vendimeve ligjore të vëzhguara, përgjithësisht respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendimi nga gjykatat më të larta, për shkak të procesit të parregullt ligjor, në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor...”*.

Referuar akteve të 11 dosjeve që përbejnë burim vlerësimi dhe 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga ana e gjyqtares rezulton se:

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim dhe analizë logjike të integruar të faktit penal, provave dhe analizës së tyre në raport me njëra tjetrën, analizë e cila zë një peshë specifike të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve. Në analizën e faktit penal është karakteristikë e gjyqtares analiza e integruar e provave në raport me secilin fakt të evidentuar si të rëndësishëm, në lidhje me elementët e veprës penale dhe rolin e secilit të pandehur në raport me veprat penale për të cilat procedohet. Në vendimet në të cilat vlerësimi i gjykatës lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal ka qenë i ndryshëm nga akuza e sjellë për gjykim nga Prokuroria, gjyqtarja analizon faktin dhe provat respektive, në drejtim të mbështetjes së konkluzionit të saj për ekzistencën ose jo të elementëve të veprës penale për të cilën procedohet, si dhe të kualifikimit të ndryshëm të faktit penal për të cilin konkludon.

Në lidhje me cilësinë e analizës së dispozitave ligjore dhe aplikimin e tyre mbi faktet konkrete të çështjes, në pjesën më të madhe të vendimeve identifikohet referimi i dispozitave të ligjit dhe aplikimi i drejtpërdrejtë i tyre mbi rrethanat e faktit, pa u shoqëruar me analizë ligjore të veçantë të kuptimit të tyre. Analiza e dispozitave dhe e kuptimit të tyre rezulton të jetë bërë vetëm në disa vendime, kur është vlerësuar e nevojshme, duke u lidhur drejtpërdrejt me rrethanat e faktit.

Konkretisht, në lidhje me analizën e dispozitave të ligjit procedural penal, rezulton referim i dispozitave ligjore në lidhje me aplikimin e gjykimit të shkurtuar, ndarjen e çështjeve, kompetencën e gjykatës (dosja 9), por nuk identifikohet një analizë e dispozitave përkatëse dhe e kuptimit të tyre, duke u ndalur vetëm në referimin e neneve respektive dhe dhënien e konkluzionit të gjykatës në zbatim të tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Në pjesën e vlerësimit të gjykatës, ku merren në shqyrtim ekzistenca dhe provueshmëria e faktit penal, kualifikimi ligjor i tij dhe fajësia e të pandehurve, si dhe roli i tyre në raport me faktin, kryesisht analiza dhe arsyetimi përqendrohet duke i dhënë një peshë specifike faktit penal të provuar në gjykim dhe vetëm në disa raste gjykata është ndalur në kuptimin dhe analizën e dispozitave ligjore në raport me faktin penal, si në rastet kur analizohet forma e kryerjes së veprës penale, në rastin e veprës penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, raste në të cilat është analizuar kuptimi i “trafikimit” apo “mbajtjes”, si forma të kryerjes së veprës penale, apo analiza e kuptimit të termit “banesë”, për të

dhënë kuptimin e termit “mbajtje në banesë”, si element i anës objektive dhe njëkohësisht element cilësues për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal.

Gjithashtu, gjyqtarja analizon në çdo rast në vendimet e dënimit rrethanat specifike për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, duke i kushtuar një seksion të posaçëm në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit, duke mbajtur në vëmendje edhe rrethanat rënduese ose lehtësuese, si dhe duke referuar për përcaktimin e llojit të institucionit të vuajtjes së dënimit në ligjin e posaçëm nr. 8328/2008, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”.

Në tërësi, arsyetimi i vendimeve përfundimtare përgjithësisht ndjek një zhvillim logjik, por i kushtohet peshë specifike parashtrimit të faktit, provave dhe analizës së tyre në raport me veprat penale dhe rolin e të pandehurve në kryerjen e tyre, duke referuar drejtpërdrejt normën ligjore (procedurale ose materiale) që gjen zbatim dhe përqsasjen e saj me faktin e provuar, në mbështetje të konkluzionit të gjykatës, pa u ndalur në analizën e koncepteve, instituteve dhe dispozitave ligjore mes tyre, apo në mënyrën se si ato gjejnë ose jo zbatim në rastin konkret.

Analiza e dispozitave ligjore është bërë vetëm në disa raste, në lidhje me elementë të caktuar (kryesisht për elementë të tillë si forma e kryerjes së veprës në disa raste) dhe zë një peshë më të vogël në arsyetimin e vendimeve, në raport me analizën e faktit penal dhe analizën e provave mbi të cilat ai mbështetet. Në rastin e ndryshimit të kualifikimit ligjor të faktit penal (vendimi 2), gjykata ka analizuar rrethanat e faktit që mbështesin konkluzionin e saj për elementë të veprës penale që ndikojnë në kualifikimin ligjor të saj, duke arritur drejtpërdrejt në konkluzionin për mungesën e provueshmërisë së tyre, ose vlerësimin e ndryshëm në raport me kualifikimin ligjor, duke mos qëndruar në mënyrë specifike në analizën ligjore të elementëve të veprës, në mbështetje të konkluzionit për ndryshimin e kualifikimit ligjor të faktit penal.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi “mbi mesatare” në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtares”

KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
87	Shumë mirë

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARES

Aftësia organizative e gjyqtarës pikëzohet duke vlerësuar aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj, si kur gjykon e vetme, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Ndërsa për shqyrtimin e kërkesave të fazës së hetimeve paraprake dhe kërkesave për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë në bazë të ligjit të posaçëm, parashikohen afate ligjore gjykimi.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për dy prej tyre (dosja 4 dhe dosja 5) ligji procedural të ketë parashikuar afat ligjor shqyrtimi.

Konkretisht, për kërkesat penale me objekt “Ekzekutim i masës së sigurimit”, neni 248 i Kodit të Procedurës Penale parashikon verifikimin e zbatimit të masës brenda afatit 3 ditor nga momenti i zbatimit. Në rastin konkret (dosja 5), seanca gjyqësore është planifikuar dhe zhvilluar duke respektuar afatin ligjor tre ditor, nga momenti i ekzekutimit të masës sipas nenit 248, pika 1, të K.Pr.Penale.

Në rastin e kërkesave për konfiskimin e pasurisë, neni 23 i Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, parashikon shqyrtimin e tyre brenda tre muajve nga data e paraqitjes së kërkesës në gjykatë dhe në çdo rast jo më vonë se një vit nga data e paraqitjes së kërkesës, në rastin e çështjeve komplekse. Në rastin konkret (dosja 4), gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 18 ditë, duke përfunduar brenda afatit ligjor një vjeçar të parashikuar në nenin 23, pika 2, të Ligjit nr. 10192, sipas parashikimeve të këtij Ligji në kohën e zhvillimit të gjykimit në fjalë.

Për sa më sipër, duke iu referuar dy burimeve të sipërcituar, çështje për të cilat ligji parashikon afate ligjore shqyrtimi, rezulton se këto afate janë respektuar. Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar dy çështjeve të analizuara më sipër, në të cilat afati ligjor i gjykimit është respektuar, ky kriter, do të pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “respektimi i afateve ligjore” vlerësohet nga “0-10%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se : “...Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} ka qenë në intervale kohore nga 44 orë e 7 minuta (shih dosjen 5 verifikimi i kushteve të zbatimit të masës së arrestit) deri në 8 muaj e 15 ditë (shih dokumenti 1), 7 muaj e 27 ditë (shih dokumenti 2), 6 muaj e 18 ditë (shih dokumenti 3), 3 muaj e 13 ditë (shih dosjen nr. 1), 1 muaj e 13 ditë (shih dosjen 2), 4 muaj e 26 ditë (shih dosjen 3) dhe 3 muaj e 18 ditë (shih dosjen 4). Në 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se është respektuar afati kohor i përcaktuar në pikën 5 shkronja “f” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, apo afatit të parashikuar në nenin 248/1 i K.Pr.Penale dhe neni 23/2 i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë...”.

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit rezulton se për 9 nga çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afati ligjor gjykimi dhe 3 vendimet, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas Vendimit nr.261/2 të KLD¹.

¹ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se :” Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo me tej

⋮
Kryesisht, gjykimi për 9 çështjet e përzgjedhura me short ka zgjatur nga 27 ditë minimalisht, në 9 muaj e 10 ditë maksimalisht, por në çdo rast, brenda standardit minimal kohor.

Në 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, gjykimi ka zgjatur përkatësisht 8 muaj e 15 ditë, 7 muaj e 27 ditë dhe 6 muaj e 18 ditë, duke respektuar standardin minimal kohor të përcaktuar, pra, nuk rezulton asnjë çështje e shqyrtuar jashtë standardit minimal kohor.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar plotësisht në të gjitha çështjet e analizuar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë e gjyqtarës në treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” vlerësohet “0 -10 %”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e posaçme (Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, në periudhën e vlerësimit).

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 9 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit². Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për kategori (të gjitha çështjet e marra në analizë janë çështje penale themeli, krime), për 9 çështjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë rreth 139 ditë, ose rreth 4 muaj e 19 ditë³.

se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

² Në metodologjinë e vlerësimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

³ Kohëzgjatja mesatare e gjykimit për 9 çështje gjyqësore, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e gjykimit edhe për 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja.

...

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është dukshëm më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale të themelit në gjykatat e shkallës së parë, për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar për të gjitha kategoritë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga K.L.GJ, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se “...Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këtë të dhëna është 95.6 %...”.

Nga të dhënat statistikore të administruara në dosje, për periudhën e vlerësimit të përbërë nga 4 vite kalendarike, dy prej të cilëve janë jo të plotë, rezulton se: Në total, në gjithë periudhën e vlerësimit, gjyqtarës {...} i janë caktuar në cilësinë e kryesueses 44 çështje penale themeli, 45 kërkesa penale administrative, 161 masa sigurimi, 225 kërkesa për përgjime dhe 21 kërkesa të tjera penale (sekustrim dhe konfiskim pasurie), sipas raportit të analizimit të aftësive profesionale, faqe 29 e tij. Në vitin 2016 ka mbartur 2 çështje për vitin 2017. Ndërkohë, rezulton se ka përfunduar në gjithë periudhën e vlerësimit, në total 257 çështje, sipas tabelave me të dhëna statistikore të administruara në faqet 103 - 109, të dosjes së rivlerësimit. Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, si dhe mospërputhje të numrit të çështjeve të përfunduara, në bazë të të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyruara në raportin e analizimit të aftësive profesionale, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 96.4 %, i përcaktuar në faqen 29 të Raportit, faqe 816 e dosjes së rivlerësimit.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e plotë të vlerësimit rezulton në masën 96.4 %.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” vlerësohet “mbi 93-99%”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “..Nga këto të dhëna rezulton se vendimet, me përjashtim të një rasti (shih dosja 1) janë arsyetuar në respektim të afatit ligjor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale dhe neni 308/2 i K.Pr.Civile (për çështjen civile antimafia)...”

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, më datë 12.10.2020, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 02.09.2020, rezulton se:

Dosja që i përket vendimit me nr. 113, datë 18.12.2013 është dorëzuar më datë 26.12.2013 (8 ditë); Dosja që i përket vendimit me nr. 148, datë 23.12.2014 është dorëzuar më datë 26.12.2014 (3 ditë); Dosja që i përket vendimit me nr. 96, datë 24.7.2014 është dorëzuar më datë 29.07.2014 (5 ditë); Dosja që i përket vendimit me nr. 102, datë 30.09.2015 është dorëzuar më datë 09.10.2015 (9 ditë); Dosja që i përket vendimit me nr. 141, datë 09.12.2015 është dorëzuar më datë 14.12.2015 (5 ditë); Dosja që i përket vendimit me nr.88, datë 21.06.2016 është dorëzuar më datë 24.06.2016 (3 ditë).

Referuar të dhënave si më sipër, për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, koha mesatare e arsyetimit të vendimit rezulton të jetë 5.5 ditë.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën

gjqësore kjo kohë gjithësesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë. Duke qenë se koha mesatare e dorëzimit të vendimit të arsyetuar nga ana e gjyqtarës në rastin konkret, është 5.5 ditë, ajo është dukshëm më e shkurtër se afati i ankimit, çka vlerësohet si një shkallë e lartë kujdesi që gjyqtarja ka treguar për arsyetimin në kohë të vendimeve.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar vlerësohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin afati procedural për të gjitha kategoritë të çështjeve” duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, në kuadër të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Gjyqtarja {...} përgjithësisht ka planifikuar dhe ka zbatuar me korrektesë veprimet e duhura procedurale për zhvillimin dhe përfundimin e gjykimit në një afat të arsyeshëm kohor. ...Këto të dhëna tregojnë se nga 31 seanca gjyqësore të vëzhguara, 17 seanca kanë qenë joproduktive, shkaqet e të cilave u trajtuan më sipër. Nga të gjitha seancat jo produktive rezulton se asnjë seancë nuk është për shkak të planifikimit të gabuar, apo mungesës së gjyqtarës kryesuese. Asnjë seancë nuk ka dështuar për shkak të mungesës së njoftimeve nga ana e gjykatës...”.

⋮

Nga vëzhgimi i 10 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “çështje penale themeli” dhe “konfiskim pasurie”, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, rezultojn si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short administruar në dosjen e rivlerësimit:

Dosja 1, çështja me nr. regjistri 23/135, datë regjistrimi 06.11.2013, nr. vendimi 27, datë vendimi 19.02.2014. Janë zhvilluar 10 seanca gjyqësore të dokumentuara nëpërmjet regjistrimit në sistemin audio, nga të cilat 7 kanë qenë jo produktive dhe 3 produktive;

Dosja 2, çështja me nr. regjistri 129, datë regjistrimi 16.06.2015, nr. vendimi 95, datë vendimi 29.07.2015. Janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore, nga të cilat 1 joproductive dhe 3 produktive;

Dosja 3, çështja me nr. regjistri 55/207, datë regjistrimi 17.12.2015, nr. vendimi 66, datë vendimi 13.05.2016. Janë zhvilluar 10 seanca gjyqësore, nga të cilat 6 kanë qenë jo produktive dhe 4 produktive;

Dosja 4, çështja me nr. regjistri 18, datë regjistrimi 27.05.2015, nr. vendimi 20, datë vendimi 15.09.2015. Janë zhvilluar 7 seanca gjyqësore, nga të cilat 3 kanë qenë jo produktive dhe 4 produktive;

Në çështjet e përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit:

Dosja 6, çështja me nr. regjistri 76, datë regjistrimi 21.03.2014, nr. vendimi 96, datë vendimi 24.07.2014. Janë planifikuar 13 seanca gjyqësore nga të cilat 4 kanë qenë joproductive dhe 9 produktive. (3 për mosparaqitjen e prokurorit, 1 për mosparaqitjen e mbrojtësit). Shkaqet e shtyrjes së seancave janë relatuar nga gjykata, si dhe rezultojn të jenë marrë masa efektive për të garantuar zhvillimin e gjykimit në seancën vijuese. (njoftimin e prokurorit, pezullimin e afateve të paraburgimit).

Dosja 7, çështja me nr. regjistri 148, datë regjistrimi 20.11.2013, nr. vendimi 113, datë vendimi 18.12.2013. Janë zhvilluar 2 seanca gjyqësore. Nuk ka seanca jo produktive.

Dosja 8, çështja me nr. regjistri 139, datë regjistrimi 18.07.2014, nr. vendimi 148, datë vendimi 23.12.2014. Janë zhvilluar 11 seanca gjyqësore, nga të cilat 3 kanë qenë jo produktive dhe 8 produktive. (2 për mosparaqitjen e prokurorit, 1 për mosformimin e trupit gjykues).

Dosja 9, çështja me nr. regjistri 82, datë regjistrimi 27.02.2015, nr. vendimi 102, datë vendimi 30.09.2015. Janë zhvilluar 17 seanca gjyqësore, nga të cilat 11 kanë qenë jo produktive dhe 6 produktive. (4 për mosparaqitjen e prokurorit, 2 për mosparaqitjen e të pandehurit, 2 për mosparaqitjen e mbrojtësit, 2 për shkak të mosformimit të trupit gjykues, 1 seancë e planifikuar në ditë pushimi).

Dosja 10, çështja me nr. regjistri 176, datë regjistrimi 16.10.2015, nr. vendimi 141, datë vendimi 09.12.2015. Janë planifikuar 4 seanca gjyqësore, nga të cilat janë zhvilluar 3 seanca produktive dhe 1 seancë jo produktive (për mosparaqitjen e prokurorit).

Dosja 11, çështja me nr. regjistri 81/233, datë regjistrimi 31.12.2015, nr. vendimi 86, datë vendimi 22.06.2016. Janë planifikuar 12 seanca gjyqësore, nga të cilat janë zhvilluar 9 seanca jo produktive dhe 3 produktive (3 për mosparaqitjen e të pandehurës, 4 për mosparaqitjen e mbrojtësit të caktuar kryesisht, 2 për mosformim të trupit gjykues). Shkaqet e shtyrjes së seancave janë relatuar nga gjykata, si dhe rezultojn të jenë marrë masa efektive për të garantuar zhvillimin e gjykimit në seancën vijuese. (pezullimin e afateve të paraburgimit).

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezultojn se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja, në çështjet e vëzhguara variojnë nga 2, deri në 17 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 10 çështjeve të vëzhguara, rezultojn të jetë 9 seanca.

⋮
Nga vëzhgimi i 10 dosjeve (çështje themeli me palë) të çështjeve të përzgjedhura me short rezulton se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen.

Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë të afërt. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: lënia kohë mbrojtësve të zgjedhur të të pandehurit për t'u njohur me aktet e dosjes⁴, lënia kohë palës së paditur dhe përfaqësuesve të saj për të shprehur qëndrimin lidhur me kërkesëpadinë dhe aktet provuese⁵, për të njoftuar shtetasit e thirrur në cilësinë e dëshmitarëve⁶, lënien kohë të pandehurit për të shprehur qëndrimin e tij nëse dëshiron të japë shpjegime⁷, kërkimi i të pandehurit edhe në territore të tjera të Republikës së Shqipërisë⁸, komunikimi i vendimit të mosgjetjes së të pandehurit dhe ekstraktit të procesverbalit të seancës gjyqësore mbrojtësit të zgjedhur⁹, dhënia kohë palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtar në referim. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, të përcaktuara në nenin 342 paragrafi 2 të K.Pr.Penale.

Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore, konstatohet respektimi në çdo rast i afatit ligjor për caktimin e seancave (*afati 10 ditor për caktimin e seancës gjyqësore sipas parashikimeve të nenit 333 paragrafi i 1 të K.Pr.Penale, afati 15 ditor për caktimin e seancës gjyqësore sipas nenit 342 paragrafi 2 të K.Pr.Penale*).

Referuar sa më sipër, për treguesit e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 10 çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet është 9 seanca. Pavarësisht numrit mesatar të seancave, gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë..

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi

⁴ Dosja 2, çështja me nr. regjistri 129, datë regjistrimi 16.06.2015, nr. vendimi 95, datë vendimi 29.07.2016

⁵ Dosja 4, çështja me nr. regjistri 18, datë regjistrimi 27.05.2015, nr. vendimi 20, datë vendimi 15.09.2015

⁶ Dosja 6, çështja me nr. regjistri 76, datë regjistrimi 21.03.2014, nr. vendimi 96, datë vendimi 24.07.2014;

Dosja 8, çështja me nr. regjistri 139, datë regjistrimi 18.07.2014, nr. vendimi 148, datë vendimi 23.12.2014;

⁷ Dosja 6, çështja me nr. regjistri 76, datë regjistrimi 21.3.2014, nr. vendimi 96, datë vendimi 24.7.2014

⁸ Dosja 9, çështja me nr. regjistri 82, datë regjistrimi 27.2.2015, nr. vendimi 102, datë vendimi 30.9.2014

⁹ Dosja 9, çështja me nr. regjistri 82, datë regjistrimi 27.2.2015, nr. vendimi 102, datë vendimi 30.9.2014

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” vlerësohet “1-3 seanca dhe /ose shkallë shumë e lartë e aftësisë” duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga K.L.GJ në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues konkludohet se “Në çeljen e seancave ka patur edhe raste të fillimit me vonesë nga orari i planifikuar, të cilat kanë kaluar edhe 15 minuta nga orari i planifikimit. Nga 31 seanca gjyqësore të analizuara rezulton se 8 seanca janë zhvilluar mbi 15 minuta vonesë nga orari i planifikuar. Seancat me vonesa të mëdha nga 23 deri në 32 minuta kanë si shkak vonese pritjen e anëtarëve të trupit gjykues, të cilët kanë qenë në gjykime të tjera që kanë zgjatur tej planifikimit dhe vonesën e prokurorit. Në përgjithësi për seancat gjyqësore me vonesa të mëdha është relatuar nga kryetari i seancës shkak i fillimit me vonesë të seancës. Në një dosje (dosja nr. 5) ku subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtar i vetëm, seanca gjyqësore ka filluar në orarin e planifikuar. Nga 5 dosjet e vëzhguara 4 prej tyre; 3 çështje penale themeli dhe 1 civile antimafia janë dokumentuar me regjistrim audio (shih dosjet 1, 2, 3)....”.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtare (10 çështje) dhe kërkesa penale të hetimit paraprak (1 çështje), lidhur me kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, rezulton si më poshtë:

Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjen, duke marrë vendim për caktimin e seancës së parë gjyqësore, në çdo rast 1 deri në 5 ditë pas caktimit të çështjes me short, duke respektuar afatin procedural 10 ditor të parashikuar në nenin 333/1 të K.Pr.Penale. Në 10 dosjet e vëzhguara rezulton se gjyqtarja ka caktuar datën e seancës së parë gjyqësore, brenda ditës së caktimit në 1 prej tyre (dosja 8), është caktuar 1 ditë pas caktimit në 4 prej tyre (dosja 6, 9, 10, 11), 2 ditë pas caktimit në 2 prej tyre (dosja 3, 4), brenda 4 ditëve në 2 prej tyre (dosja 2, 7) dhe brenda 5 ditëve në 1 prej tyre (dosja 1).

Seancat gjyqësore për 10 dosjet që i përkasin çështjeve të themelit, janë planifikuar dhe zhvilluar brenda afatit procedural 15 ditor, të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale, përveç rasteve të periudhës së lejes në muajin gusht¹⁰, të cilat përbëjnë të vetmet raste të tejkalimit të afatit 15

¹⁰ Dosja 1, Dosja 8

ditore për caktimin e seancave në procesin penal. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës së prokurorisë në lidhje me zbatimin e masës së sigurimit (dosja 5), gjykata ka marrë masa efektive për të mundësuar planifikimin dhe zhvillimin brenda afatit ligjor të shqyrtimit, sipas nenit 248 të K.Pr.Penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe të pasqyruar në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretari gjyqësore. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal, sipas parashikimeve të nenit 335 e vijues të K.Pr.Penal dhe 405 e vijues të K.Pr.Penale, në rastet e procedimit me gjykim të shkurtuar. Gjatë zhvillimit të gjykimit tregohet kujdes i posaçëm për të relatuar regjistrimin e seancës në sistemin audio, relatimi i verifikimit të paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimi i akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, marrjen e vendimeve për zhvillimin e gjykimit në mungesë, sipas parashikimeve të nenit 351 dhe 352 të K.Pr.P, sipas rastit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), administrimin e provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, shoqërimin e të pandehurve, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, etj.).

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes (*në rastet e disponimit për kërkesat paraprake të palëve, shtyrjen e seancave etj.*).

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht me vonesë, me disa minuta, shoqëruar përgjithësisht me relatimin e shkakut që ka shkaktuar vonesën në çeljen e seancës, por asnjëherë nuk rezulton që seancat të mos jenë zhvilluar për shkak të kësaj vonese.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie mbi mesataren në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e vënies në lëvizje të dosjes në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore, planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, seancat gjyqësore të zhvilluara, përveç fillimit të seancave, ku konstatohet se përgjithësisht seancat janë çelur me vonesë, nga orari i planifikuar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 16 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ në kuadër të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota...”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes konstatohet se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve gjyqësore është e rregullt dhe dokumentacioni lehtësisht i aksesueshëm, duke përmbajtur aktin e shortit, urdhrin e formimit të turpit gjykues, vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet në rend kronologjik, provat e administruara për herë të parë në dosje për shkak të pranimin të kërkesës për gjykim të shkurtuar, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGJ në kuadër të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota...”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se, në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (provat e administruara për herë të parë në seancë për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, diskutimet përfundimtare të palëve). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtares”

KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
94	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rasteve pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

⋮

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në raportin e hartuar nga KLGJ në kuadër të rivlerësimit, konkluzionet se “...Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, gjatë periudhës së rivlerësimit “08 tetor 2013-08 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} është paraqitur 1 ankesë në vitin 2014. Ankesa e paraqitur në vitin 2014 verifikuar bazuar në raportin periodik të kryetarit në lidhje me vendimet e cenuara i është regjistruar gjyqtares për vlerësim profesional dhe etik...”.

Nga të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ, rezulton se për periudhën e vlerësimit Tetor 2013-Tetor 2016, gjatë së cilës ka filluar dhe përfunduar verifikimi nga Inspektorati i KLD, nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuara në relacion e përgatitur nga inspektori, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares.

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezultojnë të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore. Rezulton të jetë paraqitur vetëm një ankesë¹¹ në vitin 2014, e cila është trajtuar nga Inspektorati i KLD, me relacionin e datës 03.10.2016. Në raportin e Inspektoratit të KLD, pasi analizohet situata e faktit dhe e ligjit, konkludohet se :”...2. Cenimi i vendimit nr.69, datë 14.11.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda duhet të mbahet në konsideratë gjyqtarëve : Klodian Kurushi, Sandër Simoni, Nertina Kosova, {...} dhe Luan Hasneziri, për efekt të vlerësimit etiko profesional të tyre së bashku me analizën e mësipërme”.

Vendimi, i cili ka qenë objekt verifikimi nëpërmjet raportit si më sipër, mban datën 14.11.2012 dhe si i tillë, nuk bën pjesë në periudhën e vlerësimit Tetor 2013- Tetor 2016. Edhe nëse ky vendim do t’i përkiste periudhës së vlerësimit, në Ligjin nr.96/2016 dhe aktet nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit, cenimi i vendimeve nga gjykatat më të larta në kuadër të shqyrtimit të ankimit të palëve, nuk përbën një tregues për efekt të vlerësimit, të aftësive në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares. Për periudhën e vlerësimit Tetor 2013-Tetor 2016, gjatë së cilës ka filluar dhe përfunduar verifikimi nga Inspektorati i KLD, nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuara në relacion, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares.

¹¹ Material i ardhur nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykata e Lartë, lidhur me cenimin e disa vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në raportin e hartuar nga KLGJ në kuadër të rivlerësimit, konkludohet se “...Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm...”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin e përgatitur nga K.L.GJ, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat arkivore të KLGJ/KLD;
- Vendime për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezulton të jetë paraqitur vetëm një ankesë, referuar në treguesin më sipër, e cila i është regjistruar gjyqtarës për vlerësim profesional dhe etik. Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe analizuara në relacion nga Inspektorati i KLD, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës, apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës.

Nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarës, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmëritë e publikut. Nga raporti i ILDKPKI i administruar në procesin e rivlerësimit kalimtar, që përkon me periudhën e vlerësimit, konkludohet se gjyqtarja nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme, apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të

lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në raportin e hartuar nga KLGJ në kuadër të rivlerësimit konkludohet se “..Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Ilirina {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale, me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme...”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Të dhënat statistikore.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës në periudhën e vlerësimit.

Në raportin e analizimit të aftësive profesionale të përgatitur nga KLGJ në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se “...Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve...”.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, konkludohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës duhet të jetë i pa konsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës, është i pa konsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” vlerësohet “i pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

•
•
•
•
•

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter, në raportin e hartuar nga KLGJ në kuadër të rivlerësimit konkludohet se “..Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse në seancat gjyqësore. Në rastin, kur i drejtohet të tretëve me shkresa, komunikimi është i qartë dhe i sjellshëm. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtarit dhe as kërkesa të vetë gjyqtarës për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes...”.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (institucioneve të paraburgimit, drejtorive të policisë etj, për

...

marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve) është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short);

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

⋮

Lidhur me këtë nënkriter në raportin e hartuar nga KLGJ në kuadër të rivlerësimit konkludohet se “..Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta...”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar vërtetimeve me nr. 397/1 Prot., datë 13.10.2016 dhe nr. 77 Prot., datë 20.01.2017 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetë deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtares, rezulton se ajo ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues.

Referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr. 397/1 Prot., datë 13.10.2016 dhe nr. 77 Prot., ditë 20.01.2017 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetë deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtares së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në 6 aktivitete trajnuese të zhvilluara në 9 ditë, të gjitha në fushën e së drejtës penale.

Gjithashtu, ka marrë pjesë në tre aktivitete trajnuese, jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës si më poshtë.

- “Cilësia, aplikimi dhe forcimi i legjislacionit”, i organizuar nga Instituti T.M.C. ASSER dhe i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës, në Hagë, Holandë, më 12-22 prill 2015, e dokumentuar me certifikatë dhe me programin e trajnimit në gjuhën angleze;
- “Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore – Faza 2, Ndjekja penale në trafikimin e qenieve njerëzore – Eksplorimi i qasjeve të reja”, i organizuar nga ICMPD, në Vjenë, më 24-25 nëntor 2015, e dokumentuar me listën e pjesëmarrësve në gjuhën angleze;
- “Mbi krimin e organizuar”, i organizuar nga OPDAT, në Tiranë, 19-21 nëntor 2013, e dokumentuar me certifikatë në gjuhën angleze.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës penale, gjithsej 9 aktivitete të zhvilluara për 24 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tri vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Sh.M dhe trajnime të tjera profesionale, vlerësohet nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari trajnuese si eksperte ose lehtësuese në programin e SH.M apo të ndonjë institucioni tjetër.

⋮
Gjithashtu, lidhur me gatishmërinë e saj për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional nuk rezultojnë të dhëna.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lektore dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, në treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, rezulton të jetë referuar për angazhimin e saj në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj. Konkretisht rezulton angazhimi i gjyqtares në tre aktivitete profesionale, si më poshtë:

- “Cilësia, aplikimi dhe forcimi i legjislacionit”, i organizuar nga Instituti T.M.C. ASSER dhe i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës, në Hagë, Holandë;
- “Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore – Faza 2, Ndjekja penale në trafikimin e qenieve njerëzore – Eksplorimi i qasjeve të reja”, i organizuar nga ICMPD, në Vjenë;
- “Mbi krimin e organizuar”, i organizuar nga OPDAT, në Tiranë.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3

...
pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, në treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në raportin e përgatitur nga KLGJ në kuadër të procesit të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarës;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, nuk mund të vlerësohet për këtë tregues.

Angazhimi i gjyqtarës dhe pikëzimi

Referuar sa më sipër, e në treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhimi i gjyqtarës dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	87	Shumë mirë
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	374	Shumë mirë